

**Republika e Kosovës—Vizita e stafit të FMN-së**  
**Deklaratë përmbyllëse**  
Prishtinë

24 Qershor, 2009

1. **Vetëm pak më shumë se një vit pas pavarësisë, Kosova do të bëhet anëtare e FMN-së dhe e institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare.** Hyrja e shpejtë e vendit në këto institucione është dëshmi e përpjekjeve të palodhshme të autoriteteve dhe e përkushtimit për të përmirësuar stabilitetin dhe mirëqenien e këtij shteti të ri. Anëtarësimi në FMN siguron një mundësi unike për tu mbështetur në progresin e arritur me shumë mund dhe për t'u marrë me sfidat makro-financiare që qëndrojnë përpara. Misioni përgëzon autoritetet për të arriturat e tyre dhe pret të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm.

*Perspektiva e afërme—Rreziqet mbesin të larta përkundër performansës së mirë të rritjes*

2. **Recesioni në Evropë deri më tani ka pasur ndikim të vogël në rritjen reale për faktin që baza eksportuese e ekonomisë është e vogël dhe shpenzimet publike po rriten me një ritëm të shpejtë.** Po vërehet një ngadalësim i vazhdueshëm në rritjen e remitencave, të importeve, kredive të sektorit privat dhe Investimeve të huaja direkte, dhe të gjitha këto sugjerojnë për një moderim në rritjen e kërkesës vendore. Këto forca shtrënguese janë kompensuar pjesërisht nga rritja e shpejtë e shpenzimeve publike që pritet të zgjerojnë në masë të konsiderueshme deficitin fiskal këtë vit. Për më tepër, ndikimi në rritjen e BPV-së nga tkurrja e dukshme e eksporteve është heshtur, marrë parasysh bazën tepër të ngushtë eksportuese të ekonomisë. Në dritën e kësaj, misioni parashikon një ngadalësim të lehtë të rritjes reale në 3½ për qind në vitin 2009. Madhësia e vogël e sektorit të eksportit—ndonëse ndikon në frenimin e bartjes negative nga tkurrja e këtij viti në tregtinë ndërkombëtare—do të ndrydhë gjithashtu impulsin nga ripërtëritja globale që pritet të nisë vitin e ardhshëm. Marrë parasysh planet për kontroll të shpenzimeve publike, rritja reale pritet të rritet për rreth 4 për qind në vitin 2010.

3. **Megjithatë, rreziqet vazhdojnë të tregojnë për një përkeqësim të mundshëm.** Ndonëse sektori bankar i Kosovës ka mbetur stabil, është herët të konkludohet që rreziqet të cilat rrjedhin nga kriza financiare ndërkombëtare janë zhdukur tërësisht. Për shumë banka evropiane mbetet edhe më tej të njohin masën e plotë të humbjeve të tyre. Prandaj, përkeqësimi i situatës financiare të bankave amë mund të ketë ndikim në degët e tyre në mbarë Evropën dhe si rezultat i kësaj, të ketë ndikim edhe në performansën ekonomike të vendeve pritëse të tyre, përfshirë këtu Kosovën.

*Qëndrueshmëria fiskale—e dobësuar nga shpenzimet Ad Hoc dhe nga politikat e financimit*

4. **Politikat fiskale janë pa një drejtim apo qëllim të qartë—politikave prioritare u mungon qartësia dhe menaxhimi i shpenzimeve është i çlirët.** Buxheti i këtij viti është bazuar në parashikimin joreal të neutralitetit buxhetor të një huaje të konsiderueshme nga buxheti për KEK-un (3¼ për qind e BPV-së), që është kompania energjetike publike. Privatizimi i KEK-ut dhe shlyerja e kësaj huaje nga pronari i ri është parashikuar të

kompensojë në buxhetin e këtij viti shpenzimet kapitale që lidhen me zgjatjen e kësaj huaje. Megjithatë, vonesat e vazhdueshme rreth privatizimit sipas të gjitha gjasave do të rezultojnë në një rritje të theksuar në shpenzimet kapitale, edhe pse shuma e buxhetuar e huasë mund të reduktohet edhe më tej. Misioni vlerëson rëndësinë e politikave për energjinë dhe implikimet e saj për ekonominë dhe sigurinë nacionale. Sido që të jetë, marrë parasysh prioritetin e lartë që i është dhënë politikës së energjisë nga ana e qeverisë, duhet të jetë e gatshme për të harmonizuar shpenzimet e rritura që lidhen me energjinë, me shkurtimeve të shpenzimeve në sektorë të tjerë, për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale. Në vend të kësaj, ka nevoja shtesë të pa financuara që shkaktojnë fryrjen e shpenzimeve buxhetore të këtij viti për të paktën 1½ për qind të BPV-së. Si rezultat i kësaj, misioni projektton një rritje të shpenzimeve qeveritare për 39 për qind këtë vit, dhe rreziqet fiskale mund të shkaktojnë presione shtesë.

- *Rishikimi i buxhetit në gjashtëmuor (RBGj).* Në kundërshtim me instruksionet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), ministrinë shpenzuese kanë kërkuar alokime shtesë me RGj dhe qeveria tani po shqyrton mundësinë e një rritjeje shtesë të shpenzimeve në mbi 1½ për qind të BPV-së këtë vit. Nuk do të duhej lejuar asnjë rritje—ato vetëm sa do të vinin në dyshim politikën e gjithmbarshme të shpenzimeve të qeverisë dhe do të krijonin një precedent të rrezikshëm për përgatitjen e buxhetit 2010.

- *Rreziqet fiskale.* Gjendja e gjysmërrënuar e KEK-ut mund të rezultojë në importe të kushtueshme shtesë të energjisë; kostoja e financimit të projektit të autostradës drejt Shqipërisë, e konsideruar si pjesë e Rishikimit të buxhetit në gjashtëmuor, nuk është vlerësuar si duhet dhe rrezikon që qeveria të marrë përsipër obligime për shpenzime të konsiderueshme në të ardhmen; projekti i fibrave optik për shkollat (2 për qind e BPV-së) aktualisht nën shqyrtim nga PTK, si kompani publike e postës dhe telekomunikacionit, nëse realizohet, paraqet ofrim të shërbimit publik dhe në parim duhet të llogaritet si investim publik; në fund, thirrjet për rritje të reja të pagave para zgjedhjeve lokale të nëntorit duhet të kundërshtohen

5. **Iniciativat e fundit ligjore mund të krijojnë presione shtesë për shpenzime.** Disa ligje dhe dokumente për politikën janë miratuar pa shqyrtuar si duhet koston fiskale të kombinuar të tyre dhe pajtueshmërinë e tyre me prioritetet e vendosura në kornizën afatmesme të shpenzimeve të qeverisë. Këto përfshijnë Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e Deputetëve (anëtarëve të Kuvendit), Ligjin për Shërbimin Civil, dhe Ligjin për pagat e shërbyesve civil, si dhe Letrën e bardhë për politikën sociale. Ndërsa implementimi i këtyre politikave ka mundësi të shtyhet për vitin e ardhshëm, këto mandate të pa financuara do të shtojnë të paktën rreth 1 për qind të BPV-së në shpenzimet e ardhshme.

6. **Pa shkurtime substanciale të shpenzimeve, financimi ad hoc i deficitit paraqet rreziqe që konsiderueshme për stabilitetin makroekonomik.** Nëse të gjitha shpenzimet ekzekutohen në tërësi, deficiti fiskal ka gjasa të arrijë në rreth 11 për qind të BPV-së këtë vit. Ndërsa misioni kupton që shkalla e ekzekutimit të projekteve investuese dhe e disa shpenzimeve rrjedhëse mund të arrijë në rreth 80 për qind, deficiti buxhetor edhe më tej do të arrijë në afërsisht 8 për qind të BPV-së. Janë tri opsione kryesore për financim të deficitit: (i) thithja e bilancit bankar të qeverisë në BQK; (ii) shpenzimi i dividendit që pritet të paguhet nga PTK; dhe (iii) huazimi nga institucionet financiar pas aprovimit të Ligjit për borxhin publik. Të tri këto opsione rrezikojnë dëmtimin e stabilitetit makroekonomik, dhe ky

rrezik duhet të merret parasysh gjatë përcaktimit të prioritetëve për shpenzime dhe nivelit të deficitit.

- *Bilanci bankar.* Një reduktim në bilancin bankar kufizon edhe më tepër mundësinë e autoriteteve për të intervenuar në sektorin financiar, në rast nevojë. Ndërsa sektori ka mbetur stabil, bërja e politikave në mënyrë të kujdesshme shtron nevojën për përgatitje për mundësinë e mungesës së likuiditetit. Nëse nuk adresohet në mënyrën e duhur, pasojat e asaj mungese të likuiditetit padyshim që mund të jenë serioze për makro stabilitetin dhe sigurinë nacionale.
- *Dividendi i PTK-së.* Depozitat e PTK-së janë një burim me rëndësi i financimit për sektorin bankar (17 për qind e depozitave totale në fund të majit 2009). Nëse pranohet pagesa e dividendit nga PTK, qeveria synon të depozitojë këto fonde në bankat e njëjta komerciale që aktualisht mbështeten në depozitat e PTK-së si financim. Ndërsa pagesa e dividendit në vetvete nuk do të çrregullonte financimin e bankave, shfrytëzimi i tij si financim buxhetor do ta bënte këtë.
- *Huazimi publik.* Rreziku kryesor është zëvendësimi i investimeve të sektorit privat me ato të sektorit publik, për faktin që rritja e kredive të sektorit privat vazhdon të ndjekë për së afërmi atë të depozitave.

***Rekomandimet për politikën—Prioritizimi i shpenzimeve, Politikën fiskale kredibile dhe përmirësimet në Administratën Tatimore***

7. **Së pari, prioritetet për shpenzimet duhet të rivlerësohen dhe shkurtime të konsiderueshme të shpenzimeve janë të nevojshme për të kthyer qëndrueshmërinë fiskale.** Bazuar në ekzekutimin e buxhetit deri në këtë moment të vitit, alokimet e shpenzimeve kapitale duhet të prioritizohen sërish për të identifikuar hapësirën për zvogëlim të mëtejshëm të shpenzimeve. Shtrirja e këtyre shkurtimeve duhet të përcaktohet me qëllim të ruajtjes së një niveli të kënaqshëm të bilancit bankar që mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe më përgjithësisht, për ta vënë financimin e deficitit në një pozitë solide.

8. **Së dyti, nevojitet një pikëmbështetje kredibile për të përforcuar politikën fiskale dhe për të rifituar kontrollin—njëherë e mirë—mbi shpenzimet dhe deficitin.** Përveç që u mungojnë prioritetet për shpenzime dhe rreziqet që ekzistojnë nga sektori i energjisë, politikën buxhetore u nënshtrohen pasigurive të mëdha gjatë periudhës afatgjate nga (i) parashikimi i ardhshëm i hises së Kosovës në borxhin e ish Jugosllavisë dhe ndikimi i tij në nivelin e borxhit të jashtëm të Kosovës; (ii) niveli dhe kohëzgjatja e përkrahjes së donatorëve dhe shkalla e lëshimeve të tij; dhe (iii) ndryshimet e afërta të mëdha strukturore që ndikojnë në përbërjen e të hyrave dhe shpenzimeve fiskale. Në dritën e këtyre pasigurive, është me rëndësi që politikën buxhetore të nxirren nga një makro kornizë e qëndrueshme afatmesme që siguron qëndrueshmërinë fiskale dhe të jashtme, duke i kushtuar vëmendje njëkohësisht nevojave të mëdha për zhvillim të Kosovës. Autoritetet duhet të shqyrtojnë mundësinë e futjes së caqeve të politikave që rezultojnë nga një kornizë e tillë, në një rregull fiskale të thjeshtë dhe transparente; kjo do të tregojë dhe dobishme në përcaktimin dhe komunikimin e politikave. Megjithatë, efikasiteti i rregullës fiskale varet nga mbështetja politike për të, dhe mbështetja nga niveli më i lartë politik është i domosdoshëm për sukses. Misioni është i

gatshëm të zhvillojë, në bashkëpunim me autoritetet, një rregull fiskale të thjeshtë që është në përputhje me makro kornizën afatgjatë gjatë vizitave të ardhshme të tij.

9. **Së treti, duhen shtuar përpjekjet në administratën tatimore për të bërë zgjerimin e bazës tatimore.** Të ardhurat në administratën tatimore mund të zvogëlojnë nevojën për përshtatje të shpenzimeve, duke rritur qëndrueshmërinë fiskale. Misioni është i inkurajuar nga futja e planifikuar në përdorim e numrave për identifikim të tatimpaguesve për bizneset e reja, dhe zgjerimi i planifikuar në bizneset ekzistuese deri në mbarim të vitit. Futja e shumëpritur në përdorim e arkave fiskale, është një hap tjetër i dobishëm. Megjithatë, qeveria duhet vetëm të përcaktojë standardet për këto arka dhe sigurimin e tyre duhet t'ia lë sektorit privat. Për më tepër, misioni pret të bëhet emërimi i drejtorit të ri të administratës tatimore, kualifikimet e të cilit duhet të jenë në përputhje me sfidat që duhen tejkaluar.

#### *Politikat strukturale—Vitale për qëndrueshmërinë fiskale*

10. **Projektligji për borxhin publik kërkon modifikime të mëtejme për të mbështetur qëndrueshmërinë fiskale.** Është arritur një progres i dukshëm në ripunimin e draftit të këtij teksti shumë të rëndësishëm. Megjithatë, ekziston nevoja për adresimin e një numri çështjesh kyçe. Kushtet për huazimin komunal, të specifikuara në projektligj, duhet të jenë më të shtrenguara. Në veçanti, nevojitet një mekanizëm efektiv që certifikon kapacitetet komunale për menaxhim financiar, dhe një kufi më i matur për stokun e borxhit të tyre. Roli i BQK-së si agjent i vetëm fiskal i qeverisë duhet qartësuar gjithashtu. Veç kësaj, pajtueshmëria e projektligjit me ligjet tjera duhet vlerësuar gjithashtu. Staf i FMN-së është i gatshëm të vazhdojë punën me MEF-in dhe me BQK-në, për të siguruar që ligji i Kosovës për borxhin publik do të mbështesë stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë fiskale.

11. **E fundit, por jo më pak e rëndësishme, detyra e vetme më e rëndësishme dhe më urgjente është lëvizja me vendosmëri drejt reformimit të sektorit të energjisë,** ashtu si është diskutuar gjerësisht në misionet e mëhershme. Kostoja vjetore e sektorit të energjisë për buxhetin është të paktën 3½ për qind e BPV-së dhe në rritje. Prandaj, miratimi i një nga dy strategjive konkurruese për sektorin e energjisë, të propozuara nga Banka Botërore dhe USAID, duket të jetë më e mirë se sa mosveprimi. Megjithatë, misioni nxitë autoritetet që të vlerësojnë me kujdes implikimet fiskale të cilësdo prej këtyre strategjive dhe që të konstatojnë fizibilitetin e tyre, duke përfshirë këtu të dhënat nga testimet e tregut. Marrë parasysh vonesat e gjata rreth implementimit, nevojiten përpjekje të reja të konsiderueshme për të përmirësuar inkasimin dhe faturimin në KEK, për të pakësuar rreziqet kuazi-fiskale në periudhën e ndërmjetme. Për më tepër, auditimet e operacioneve financiare, përfshirë këtu ato për importet e energjisë, duhet të merren për bazë për të forcuar financat e KEK-ut.

#### *Stabiliteti i sektorit financiar—Nevojitet një koordinim më i ngushtë i politikave dhe një rregullim më i rreptë*

12. **Koordinimi i ngushtë ndërmjet sektorit financiar dhe politikave fiskale është vital për të mbështetur stabilitetin makroekonomik.** Deri më tani, kriza financiare ndërkombëtare ka pasur një efekt mjaft të kufizuar në sektorin financiar të Kosovës. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të mbetet i ekspozuar ndaj rrezikut të vështirësive financiare në bankat e huaja amë. Këto mund të ushtrjnë presione në Kosovë dhe mbase do të mund të rezultojnë në një mungesë të likuiditetit. Së këndejmi, bashkëpunimi më i mirë

dhe koordinimi i ngushtë i politikave ndërmjet BQK-së dhe MEF-it është i nevojshëm për të zbutur ato rreziqe.

- *Ligji për bankën qendrore dhe koordinimi i politikave.* Me legjislacionin aktual, BQK nuk ka autoritetin për të siguruar likuiditet për sektorin bankar. Projektligji, i hartuar me asistencën e FMN-së, siguron një autoritet të limituar diskrecional për BQK-në në këtë drejtim. Prandaj, misioni nxitë autoritetet që të bëjnë miratimin e shpejtë të këtij drafti. Ndërkohë, BQK dhe MEF-i duhet të rrisin koordinimin e tyre për të adresuar vështirësitë potenciale në sektorin bankar.
- *Funksioni i huadhënësit të mjetit të fundit.* Ndërsa shfrytëzimi i euros ka siguruar një stabilitet të mirëseardhur, euroizimi bën që politika fiskale të jetë instrumenti i vetëm kryesor makroekonomik. Objektivat e politikave fiskale duhen zgjeruar për të njohur përgjegjësinë e autoriteteve fiskale për stabilitetin e sektorit financiar. Në veçanti, bilanci bankar i qeverisë duhet mbajtur në një nivel adekuat. Për më tepër, vendimet që mund të dobësojnë stabilitetin e sektorit bankar—përfshirë këtu varësinë e mundshme në pagesat e dividendit të PTK-së si financim buxhetor—duhen shmangur gjithashtu.
- *Ngushtimi i limiteve të ekspozimit.* Për të ruajtur likuiditetin e bankave vartëse, BQK duhet të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së limiteve të ekspozimit bruto të bankave vartëse ndaj bankave të tyre amë, si shtesë ndaj limiteve ekzistuese ndaj ekspozimit neto.

13. **Ngadalësimi ekonomik më i theksuar nga sa është pritur, ngrit mundësinë e rritjeve të theksuara në huat jo-vijuese (HJP).** HJP-të në mbarë sistemin janë gjerësisht në linjë me vendet krahasuese të rajonit, dhe BQK duhet të vazhdojë të sigurojë klasifikimin e duhur të tyre. Për më tepër, rregullatori duhet të jetë vigjilent dhe të vazhdojë aktivitetet mbikëqyrëse të tij. Në mjedisin financiar ekzistues global, rreziqet duhet të menaxhohen në mënyrë proaktive në sektorët e sigurimeve dhe të bankave.

\*\*\*\*\*

*Dëshirojmë të falënderojmë bashkëbiseduesit tanë për mikpritjen e tyre dhe për diskutimet e dobishme.*

Tabela 1. Kosova: Treguesit kryesor, 2007-12

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
	Vler.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.
<b>Shkallët e rritjes reale (në përqindje)</b>						
BPV	5	5.4	3.4	3.8	4.6	4.7
Kontributi i asistencës së jashtme në rritjen e BPV-së	-0.6	1	0.5	-0.4	-0.7	-0.7
Të ardhurat e lira të sektorit privat	3.1	7.3	1.9	2.8	3.3	3.9
Konsumi i sektorit privat	8.1	5.3	1.3	3.7	3.9	4.2
BPV për kokë banori	3.8	3.6	1.7	2	2.8	3
Konsumi privat për kokë banori	7	3.5	-0.5	2	2.3	2.5
<b>Ndryshimet e çmimeve (në përqindje)</b>						
IÇK (inflacioni mesatar vjetor)	4.2	9.4	-2.1	2	1.7	1.7
Inflacioni nga dhjetori në dhjetor	10.4	0.5	-0.1	...	...	...
Deflatori i BPV-së	3.4	5.6	-0.9	1.9	1.3	1.3
Shkalla reale efektive e këmbimit (e bazuar në IÇK; ndryshimi mesatar vjetor)	-0.1	...	...	...	...	...
Shkalla reale efektive e këmbimit (e bazuar në IÇK; ndryshimi në fund të periudhës)	3.6	...	...	...	...	...
<b>Buxheti i qeverisë qendrore (në përqindje të BPV-së) 1/</b>						
Të hyrat	25.9	24.4	23.2	23.3	23.8	24.2
Shpenzimet	18.9	24.4	33.1	27.7	26.4	25.4
<i>Nga të cilat</i> : kapitali dhe huazimet neto	2.8	7.4	14.1	9.8	9.7	9.5
Bilanci rrjedhës	9.8	7.4	4.2	5.4	7.1	8.3
Bilanci primar	7	0	-9.9	-4.4	-2.6	-1.2
Bilanci i gjithmbarshëm (përfshirë pagesat nocionale të interesit)	...	-0.9	-10.8	-5.2	-3.3	-2
<b>Bilanci i kursimeve/investimeve (në përqindje të BPV-së) 2/</b>						
Kursimet vendore	-13	-16.1	-15.5	-13.9	-12	-10.3
Remitencat	12.4	11.7	10.2	9.9	9.8	9.6
Faktori i të hyrave neto	1.9	1.9	0.8	1	1.1	1.2
Kursimet nacionale	1.4	-2.5	-4.3	-3	-1	0.4
Investimet	26.2	28	32.9	30.9	30.9	30.6
Llogaria rrjedhëse	-24.9	-30.5	-37.2	-33.9	-32	-30.2
Asistenca e jashtme 3/	8.6	8.7	8.8	7.9	6.9	5.9
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (pas asistencës së jashtme)	-16.3	-21.8	-28.5	-26	-25.1	-24.3
<b>Shumat agregate kryesore (në miliona euro)</b>						
BPV	3,464	3,857	3,951	4,176	4,424	4,691
BPV për kokë banori (në euro)	1,629	1,784	1,797	1,867	1,945	2,028
GNDI për kokë banori (në euro)	1,863	2,026	1,998	2,070	2,158	2,246
Remitencat e punëtorëve 4/	431	452	401	414	436	449
Asistenca e jashtme 3/	340	374	384	360	333	306
Kontributi direkt i asistencës së jashtme në BPV	170	180	171	156	145	133
Popullata (në mijëra)	2,126	2,162	2,199	2,236	2,274	2,313

Burimet: Autoritetet e Kosovës; dhe vlerësimet e stafit të FMN-së.

1/ Parashikimi për vitin 2010 dhe më pas bazohet në kornizën afatmesme të shpenzimeve të autoriteteve.

2/ Bilanci i kursimeve/investimeve i tërë ekonomisë, përfshirë sektorin e donatorëve.

3/ Asistenca totale e jashtme pa përfshirë transferet kapitale.

4/ Përfshirë pensionet nga jashtë vendit.